



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 shkurt 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së
Llapit dhe Kërkesën në lidhje me Të**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21, 37 dhe 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 118(2), 137 dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 31 mars, 9 qershor, 27 korrik, 8 gusht, 3 tetor dhe 5 dhjetor 2023, Trupi Gjykses lëshoi një numër vendimesh në lidhje me mocionet për pranimin e provave jogojore të dorëzuara prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") (përkatësisht, "Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore", "Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore", "Vendimi i Tretë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore", "Vendimi i Katërt mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore", "Vendimi i Pestë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore" dhe "Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore").¹

2. Më 30 maj, 10 dhe 12 korrik, 25 gusht, 19 shtator, 3 nëntor, 15 dhjetor 2023, 15 janar, 15 mars, 19 prill, 16 dhe 27 gusht, 19 dhjetor 2024, 5 dhe 14 shkurt 2025, me autorizim të Trupit Gjykses,² Zyra e Prokurori të Specializuar ("ZPS")

¹ F01409, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 31 mars 2023, konfidencial; F01596, Trupi Gjykses, *Vendimi i Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 9 qershor 2023, konfidencial dhe *ex parte* (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua po atë ditë, F01596/CONF/RED; shënimi *ex parte* u hoq nga vendimi më 22 qershor 2023, F01596/CONF; vendimi u riklasifikua si publik më 15 nëntor 2023, F01596); F01705, Trupi Gjykses, *Vendimi i Tretë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 27 korrik 2023; F01716, Trupi Gjykses, *Vendimi i Katërt mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 8 gusht 2023, konfidencial; F01832, Trupi Gjykses, *Vendimi i Pestë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 3 tetor 2023; F01983, Trupi Gjykses, *Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 5 dhjetor 2023.

² F01352, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Çështje të lidhura me Të*, 8 mars 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 1 nëntor 2023, F01352/RED); F01544, Trupi Gjykses, *Vendim Mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin në Listën e Provave Materiale të Pesë Materialeve në lidhje me Dëshmitarin Ekspert* ("Vendimi i 23 Majit 2023"),

ndryshoi listën e provave materiale të propozuara të saj ("lista e provave materiale").³

23 maj 2023; Transkripti i seancës, 12 korrik 2023, f. 5551, rreshti 9 deri në f. 5553, rreshti 19; F01656, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Komunikimeve të Përgjuara në Listën e Provave Materiale* ("Vendimi në lidhje me Komunikimet e Përgjuara"), 7 korrik 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 14 nëntor 2023, F01656/RED); F01739, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F01728), 24 gusht 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 15 nëntor 2023, F01739/RED); F01785, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F01689 dhe F01747), 12 shtator 2023, konfidencial ("Vendimi i 12 Shtatorit 2023") (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 10 nëntor 2023, F01785/RED); F01902, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F01858) ("Vendimi i 3 Nëntorit 2023"), 3 nëntor 2023; F01995, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F01844), (Vendimi i 8 Dhjetorit 2023'), 8 dhjetor 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F01995/RED); F02044, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W01163, W02144, W02749, W04230, W04445, W04489, W04576, W04739, W04741, dhe W04820 sipas Rregullës 154 dhe Kërkesat lidhur me Të, 8 janar 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02044/RED); F02167, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F02099) ("Vendimi i 7 Marsit 2024"), 7 mars 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02167/RED); F02245, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të* W01978-ës, W02540-ës, W02677, W02714-ës, W02951-shit, W03865-ës, W03881-shit, W04371-shit, W04710-ës, dhe W04850-ës sipas Rregullës 154 dhe Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F02196), 16 prill 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02245/RED); Transkripti i seancës, 4 qershor 2024, f. 16597, rreshti 12 deri në f. 16598, rreshti 16; F02489, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W03871, W04735 dhe W04868 sipas Rregullës 154 dhe Kërkesat në lidhur me Të (F02450), 13 gusht 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02489/RED); F02501, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale* (F02279) dhe mbi Mocionin e Mbrojtjes së Thaçit për Përfundimin e Materialeve in Limine, 22 gusht 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 20 dhjetor 2024, F02501/RED); Transkripti i seancës, 23 tetor 2024, f. 20994, rreshti 7 deri në f. 20996, rreshti 9; Transkripti i seancës, 25 nëntor 2024, f. 22537, rreshti 10 deri në f. 22540, rreshti 2, konfidencial; F02787, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W04826, W04874 dhe W04875 sipas Rregullave 138, 149 dhe 154 dhe Kërkesën në lidhje me To, 16 dhjetor 2024, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02787/RED); F02883, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Pranimin e Videoincizimit pas Dëshmisë së* W04410-ës, 31 janar 2025, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02883/RED); F02913, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionin Përmbledhës të Prokurorisë për Pranimin e Provave të Dëshmitarëve* W04290 dhe W04403 sipas Rregullës 154 dhe Kërkesën Përkatëse në lidhje me W04745-ën, 7 shkurt 2025, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F02913/RED).

³ F01562, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 30 maj 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01662, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 10 korrik 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01669, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 12 korrik 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01744, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 25 gusht 2023,

3. Më 14 mars 2024, ZPS-ja dorëzoi mocionin për pranimin e dokumenteve të Zonës Operative të Llapit (“Zona Operative e Llapit”) dhe një kërkesë në lidhje me të (“Mocioni”).⁴
4. Më 18 mars 2024, Trupi Gjykses shtyu afatin për dorëzimin prej Mbrojtjes të përgjigjes së përbashkët ndaj Mocionit dhe afatin për dorëzimin prej ZPS-së të kundërpërgjigjes, përkatësisht deri më 15 prill 2024 dhe 25 prill 2024.⁵
5. Më 15 prill 2024, Mbrojtja dorëzoi përgjigjen e përbashkët ndaj Mocionit (“Përgjigja”).⁶

me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01802, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 19 shtator 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F01906, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 3 nëntor 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02014, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 15 dhjetor 2023, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02061, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 15 janar 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02184, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 15 mars 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02254, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 19 prill 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02493, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 16 gusht 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02511, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 27 gusht 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02807, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 19 dhjetor 2024, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02903, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 5 shkurt 2025, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale; F02928, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Listës së Ndryshuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 14 shkurt 2025, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

⁴ F02178, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit dhe Kërkesa në Lidhje me Të*, 14 mars 2024, me Shtojcat 1-3, konfidenciale.

⁵ Transkripti i seancës, 18 mars 2024, f. 13199, rreshtat 4-18.

⁶ F02243, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit dhe Kërkesës në lidhje me Të (F02178)*, 15 prill 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 24 prill 2024, F02243/RED).

6. Më 25 prill 2024, ZPS-ja dorëzoi kundërpërgjigjen ndaj Përgjigjes (“Kundërpërgjigja”).⁷

II. PARASHTRIMET

7. ZPS-ja kërkon: (i) përfshirjen e materialit SITF00069013-SITF00069013 dhe përkthimit të tij në anglishte SITF00069013-SITF00069013-ET (“Dokumenti Shtesë”) në listën e provave materiale të saj;⁸ dhe (ii) pranimin e dokumenteve të asaj kohe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), ndër të cilët dhe Dokumenti Shtesë (“provat materiale të propozuara”), në lidhje me zonën operative të Llapit.⁹

8. Mbrojtja përgjigjet se ZPS-ja po e përdor procedurën e pranimin të provave jogojore për të shmangur shqyrtimin e drejtë dhe efektiv të provave materiale të propozuara prej saj.¹⁰ Mbrojtja gjithashtu parashtron se Mocioni është i parakohshëm dhe kërkon që Trupi Gjykses të shtyjë vendimin e tij në lidhje me të, deri pasi të gjithë dëshmitarët përkatës të kenë dhënë dëshmitë e tyre për Zonën Operative të Llapit.¹¹ Mbrojtja gjithashtu argumenton se, në rast se Trupi Gjykses refuzon të shtyjë vendimin e tij mbi Mocionin, ai duhet të refuzojë pranimin e provave materiale të propozuara për arsyet e përcaktuara në Përgjigje dhe në Shtojcën 1 të saj,¹² të trajtuara më poshtë.¹³ Mbrojtja gjithashtu kundërshton ndryshimin e kërkuar të listës së provave materiale.¹⁴

9. ZPS-ja kundërpërgjigjet se Përgjigja shtrembëron dhe shpërfill argumentet e paraqitura në Mocion, dhe përsërit kundërshtimet e shprehura më parë prej saj

⁷ F02266, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Mocionin e saj për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Llapit (F02138)*, 25 prill 2024.

⁸ Mocioni, para. 1, 27, që i referohen Shtojcës 1 të Mocionit, prova e propozuar 125.

⁹ Mocioni, para. 1, 27, që i referohen Shtojcës 1 të Mocionit, provat e propozuara 1-290. *Shih gjithashtu Kundërpërgjigjen*, para. 6(c).

¹⁰ Përgjigja, para. 6. *Shih gjithashtu Përgjigjen*, para. 41.

¹¹ Përgjigja, para. 10, 42. *Shih gjithashtu Përgjigjen*, para. 7-9.

¹² Përgjigja, para. 4, 13-40; Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 2-255.

¹³ *Shih më poshtë pjesën (IV)(B)(3)-(5)*.

¹⁴ Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 113.

ndaj kategorive të gjera të provave, të cilat tashmë janë shqyrtuar dhe nuk janë pranuar prej Trupit Gjykses.¹⁵ Rrjedhimisht, ZPS-ja kërkon që Trupi Gjykses të miratojë Mocionin.¹⁶ ZPS-ja gjithashtu kërkon: (i) që përkthimet e disa provave materiale të propozuara të zëvendësohen me versionet e rishikuara të tyre;¹⁷ dhe (ii) autorizim për të bërë disa korrigjime të kufizuara në meta të dhënat e disa provave materiale të propozuara (konkretisht, datat dhe përshkrimet).¹⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Dispozitat ligjore të zbatueshme në lidhje me këto pika janë përcaktuar, në veçanti, në nenin 40(6)(h) dhe rregullat 118(2) dhe 138(1), dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëhershme të Trupit Gjykses.¹⁹ Trupi Gjykses do të zbatojë këto standarde në këtë vendim.

IV. DISKUTIM

A. NDRYSHIMI I KËRKUAR I LISTËS SË PROVAVE MATERIALE

11. ZPS-ja pretendon se: (i) Dokumenti Shtesë është *prima facie* relevant;²⁰ dhe (ii) ndryshimi i kërkuar është në kohë dhe nuk do të ketë asnjë efekt dëmtues për Mbrojtjen.²¹

12. Mbrojtja kundërshton ndryshimin e kërkuar të listës së provave materiale dhe argumenton se është i parakohshëm dhe dëmtues për Mbrojtjen të kërkuar

¹⁵ Kundërpërgjigjja, para. 1.

¹⁶ Kundërpërgjigjja, para. 7.

¹⁷ Kundërpërgjigjja, para. 7, që i referohet paragrafit 6(c) të Kundërpërgjigjes.

¹⁸ Kundërpërgjigjja, para. 7, që i referohet paragrafit 6(d) të Kundërpërgjigjes.

¹⁹ *Shih p.sh.* Vendimin mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 8-13; F01785, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale (F01689 dhe F01747)*, 12 shtator 2023, konfidencial, para. 15-17 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 10 nëntor 2023, F01785/RED).

²⁰ Mocioni, para. 23.

²¹ Mocioni, para. 24.

ndryshimin e listës së provave materiale, dhe në të njëjtën kohë të kërkosin pranimin si prova jогоjore të dokumenteve përkatëse.²²

13. Sipas rregullës 118(2), pasi merr njoftim në kohë dhe i tregohen arsye të vlefshme, Trupi Gjykses mund të lejojë ndryshimin e listës së dëshmitarëve dhe/ose të provave materiale të paraqitur sipas rregullës 95(4)(b) dhe (c). Në vijim të procesit gjyqsor, kërkesat për të ndryshuar listën e provave materiale do të shqyrtohen edhe më rreptësisht.²³ Siç është konstatuar më parë,²⁴ Trupi Gjykses ka lejuar disa herë ZPS-në të shtojë materiale në listën e provave dhe lista e provave tashmë është voluminoze, sipas çdo parametri. Në përputhje me këtë, Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse në këtë fazë të procesit ZPS-ja ka dhënë njoftim në kohë dhe ka treguar arsye të vlefshme për ndryshimin e listës së provave materiale dhe se kjo nuk dëmton Mbrojtjen.²⁵

14. Sa i përket njoftimit në kohë, Trupi Gjykses është i mendimit se përfshirja e Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale mund dhe duhej të ishte kërkuar prej ZPS-së në një fazë të mëhershme. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vë në dukje se ZPS-ja nuk ka kërkuar përfshirjen e Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale për shkak se ky dokument përsëriste në masë të madhe përmbajtjen e materialit P00224.²⁶ Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja argumenton se: (i) rëndësia që Dokumenti Shtesë ka si provë u bë e dukshme gjatë marrjes në

²² Shtojca 1 e Përgjigjes, f. 113.

²³ *Shih* Vendimin e 7 Marsit 2024, para. 10; Vendimin e 8 Dhjetorit 2023, para. 9; Vendimin e 3 Nëntorit 2023, para. 7; Vendimin e 12 Shtatorit 2023, para. 15, që i referohen vendimit F00727, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Listës së Provave Materiale dhe Autorizimin e Masave Mbrojtëse Përkatëse*, 8 mars 2022, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 30 (versioni i redaktuar konfidencial u dorëzua më të njëjtën ditë, F00727/CONF/RED). *Shih gjithashtu* transkriptin e seancës, 15 shkurt 2023, f. 2017-2018.

²⁴ Vendimi i 7 Marsit 2024, para. 10; Vendimi i 8 Dhjetorit 2023, para. 9; Vendimi i 3 Nëntorit 2023, para. 7; Vendimi i 12 Shtatorit 2023, para. 16.

²⁵ Vendimi i 7 Marsit 2024, para. 10; Vendimi i 8 Dhjetorit 2023, para. 9; Vendimi i 3 Nëntorit 2023, para. 7; Vendimi i 12 Shtatorit 2023, para. 16. *Për ngjashmëri* Vendimi i 23 Majit 2023, para. 8; Vendimi në lidhje me Komunikimet e Përgjuara, para. 10.

²⁶ Mocioni, para. 23.

pyetje të W02161-shit në dhjetor 2023;²⁷ (ii) për shkak të një gabimi në përkthim të nënvizuar gjatë marrjes në pyetje, më 8 janar 2024²⁸ u nxor përkthimi i rishikuar i Dokumentit Shtesë; dhe(iii) Mocioni u dorëzua në mes të marsit 2024. Gjithashtu, në kundërshtim me argumentet e Mbrojtjes, Trupi Gjykses është bindur se kërkesa për përfshirjen e dokumentit në listën e provave materiale e bërë në të njëjtën kohë me atë të pranimit të tij si provë jогоjore, *në vetvete*, nuk sjell asnjë dëm dhe rrit efikasitetin gjyqësor.²⁹ Duke pasur parasysh natyrën përsëritëse të Dokumentit Shtesë dhe faktin se përkthimi i tij iu vu në dispozicion Mbrojtjes menjëherë pas dëshmisë së W02161-shit dhe përpara dorëzimit të Mocionit, Trupi Gjykses vlerëson se njoftimi i dhënë nga ZPS-ja në lidhje me Dokumentin Shtesë është bërë në kohë.

15. Sa u përket arsyeve të vlefshme dhe aspektit të relevancës dhe rëndësisë së Dokumentit Shtesë, Trupi Gjykses vë në dukje se Dokumenti Shtesë është një listë personash (ku përfshihen dhe viktimat e përmendura në Aktakuzë të planifikuara për të dëshmuar), të cilët janë mbajtur të ndaluar nga policia ushtarake e Zonës Operative të Llapit në Llapashticë më 18 shkurt 1999. Trupi Gjykses është bindur për relevancën *prima facie* të Dokumentit Shtesë, për rëndësinë e mjaftueshme që ai ka, dhe se ka arsye të vlefshme për përfshirjen me vonesë të tij në listën e provave materiale.

16. Sa i takon efektit dëmtues, Trupi Gjykses vëren se Dokumenti Shtesë ka vetëm një faqe dhe përsërit në masë të madhe provën materiale P00224 dhe dokumente të tjera të pranuar si prova që përmbajnë informacion përkatës.³⁰ Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje se Mbrojtja ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë mundësi të shumta për të kundërshtuar mbështetshmërinë e këtyre dokumenteve. Gjithashtu, duke pasur parasysh natyrën përsëritëse të Dokumentit

²⁷ Mocioni, para. 23-24.

²⁸ Mocioni, para. 24.

²⁹ *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 113.

³⁰ *Shih p.sh.* P00003; P00010; P00104; P00116; P00738; 1D00007.

Shtesë dhe faktin se përkthimi i rishikuar i tij iu vu në dispozicion Mbrojtjes menjëherë pas dëshmisë së W02161-shit dhe përpara dorëzimit të Mocionit,³¹ Trupi Gjykses është bindur se kërkesa e njëkohshme për përfshirjen e Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale dhe pranimin e tij si provë jогоjore, nuk sjell asnjë efekt dëmtues.³² Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se përfshirja e Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale nuk shkakton asnjë dëm.

17. Për këto arsye, Trupi Gjykses konstaton se ZPS-ja ka njoftuar në kohë, ka treguar arsye të vlefshme për ndryshimin e kërkuar të listës së provave materiale dhe ka treguar se Mbrojtja nuk do të dëmtohet prej përfshirjes së Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses autorizon përfshirjen e Dokumentit Shtesë në listën e provave materiale të ZPS-së dhe urdhëron ZPS-në të dorëzojë listën e ndryshuar të provave materiale të saj deri të **premtën, 28 shkurt 2025.**

B. PRANIMI I PROVAVE MATERIALE TË PROPOZUARA

1. Parashtrimet e palëve

18. ZPS-ja parashton se provat materiale të propozuara janë *prima facie* relevante pasi ato lidhen me pretendime dhe akuza të ndryshme të përfshira në Aktakuzë dhe konfirmojnë dhe plotësojnë dëshmitë e dëshmitarëve, provat e tjera shkresore dhe faktet e konstatuara në procese të tjera.³³ ZPS-ja gjithashtu argumenton se provat materiale të propozuara janë *prima facie* autentike dhe prova në të cilat mund të mbështetesh, pasi, të para veç e veç dhe në tërësi, përmbajnë tregues të shumtë të autenticitetit, si dhe të prejardhjes së tyre.³⁴ ZPS-ja gjithashtu

³¹ *Shih më lart* paragrafin 14.

³² *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 113.

³³ Mocioni, para. 3-18; Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1-290, kolona “relevanca/vlera provuese”.

³⁴ Mocioni, para. 19-21; Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1-290, kolona “treguesit e autenticitetit”.

argumenton se provat materiale të propozuara kanë vlerë provuese, e cila nuk zhbëhet prej efektit dëmtues.³⁵

19. Mbrojtja kundërshton relevancën, autenticitetin dhe vlerën provuese të provave materiale të propozuara dhe, për rrjedhojë: (i) kërkon që Trupi Gjykses të shtyjë shqyrtimin prej tij të Mocionit deri pasi dëshmitarët e ZPS-së për Zonën Operative të Llapit të kenë dhënë dëshmitë e tyre; dhe, si alternativë, (ii) kundërshton pranimin si prova të provave materiale të propozuara.³⁶ Krahas kundërshtimeve individuale të renditura në Shtojcën 1 të Përgjigjes,³⁷ të cilat Trupi Gjykses i pati parasysh në vlerësimin prej tij të përmbushjes së kriterëve të rregullës 138(1) prej provave materiale të propozuara përkatëse,³⁸ Mbrojtja paraqet argumentet në vijim në lidhje me veçoritë e provave materiale të propozuara, të cilat, sipas Mbrojtjes, bëjnë që ato të jenë të papërshtatshme për t'u pranuar si prova jogojore.

- (a) autenticiteti i atyre që pretendohet të jenë dokumente të UÇK-së duhet të konfirmohet nga dëshmitarët, për të kuptuar kontekstin e saktë të tyre dhe për t'u dhënë mundësi dëshmitarëve të flasin për historinë, autorësinë dhe autenticitetin e dokumenteve;³⁹
- (b) ZPS-ja nuk është në gjendje të ofrojë detaje të kronologjisë së mbajtjes në ruajtje të informacionit, përtej përshkrimeve të përgjithshme se burim i tij ishin TPNJ-ja/MPNTP-ja, EULEX-i apo autoritetet serbe;⁴⁰
- (c) në provat materiale të propozuara përfshihen "grupe" voluminoze dokumentesh, ku kemi të bëjmë me një numër dokumentesh të

³⁵ Mocioni, para. 22; Shtojca 1 e Mocionit, provat materiale të propozuara 1-290, kolona "relevanca/vlera provuese".

³⁶ *Shih, në përgjithësi* Përgjigjen, para. 13, 15, 17-19, 28-29, 31-34, 36, 38-42.

³⁷ Shtojca 1 e Përgjigjes, provat materiale të propozuara 1-290, kolona "kommentet e Mbrojtjes".

³⁸ *Shih më poshtë* pjesën (IV)(B)(3)-(5).

³⁹ Përgjigja, para. 13-18. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.1, C.1.3, C.3, C.3.2, C.13 dhe R.3.

⁴⁰ Përgjigja, para. 19-27. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.6.

ndryshme të paraqitura së bashku, ndonjëherë pa ndonjë lidhje të dukshme me njëri-tjetrin ose me ngjarjet në Zonën Operative të Llapit;⁴¹

(d) dokumentet e shkruara me dorë nuk duhet të pranohen si prova jोगojore në mungesë të provave në lidhje me krijimin dhe autorësinë e tyre, veçanërisht nëse dokumenti nuk është origjinal;⁴²

(e) provat materiale të propozuara që përmbajnë dokumente dëshmish, nuk mund të pranohen si prova jोगojore;⁴³ dhe

(f) Mbrojtja e Selimit mbështetet në kundërshtimet e shprehura më parë prej saj në lidhje me provat materiale të propozuara që janë sekuestruar në banesën e z. Selimi (provat materiale të propozuara 73 dhe 289).⁴⁴

20. ZPS-ja kundërpërgjigjet se nuk ka kriter që dokumentet duhet të paraqiten përmes një dëshmitari apo se vendimi mbi pranimin e tyre duhet të shtyhet deri pasi të jenë paraqitur dëshmitarët përkatës.⁴⁵ ZPS-ja gjithashtu parashtrohet se autenticiteti dhe mbështetshmëria e provave materiale të propozuara nuk duhen vlerësuar ndarazi por në tërësi, duke marrë parasysh të gjithë informacionin dhe provat përkatëse.⁴⁶

2. Aspekte të përgjithshme

21. Trupi Gjyqësor rrëzon kërkesën e Mbrojtjes për të shtyrë shqyrtimin prej tij të Mocionit deri pasi dëshmitarët e ZPS-së për Zonën Operative të Llapit të kenë dhënë dëshmitë e tyre. Trupi Gjyqësor vëren se në kornizën ligjore të DHS-së nuk

⁴¹ Përgjigjja, para. 28-29. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.1, C.1.3, C.4, C.8, C.11, C.12 dhe C.13.

⁴² Përgjigjja, para. 30-32. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.12.

⁴³ Përgjigjja, para. 33-35. *Shih gjithashtu* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.8.

⁴⁴ Përgjigjja, para. 36, që i referohet F01387, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jोगojore*, 21 mars 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-8, konfidenciale, para. 31-51.

⁴⁵ Kundërpërgjigjja, para. 2.

⁴⁶ Kundërpërgjigjja, para. 3-5.

ekziston kriteri që autenticiteti i provave materiale të propozuara duhet të konfirmohet nga dëshmitarët.⁴⁷ Në mënyrë të ngjashme, asgjë nuk e pengon pranimin e provave materiale të propozuara si prova jogojore, kur kjo mbështetet në rëndësinë thelbësore që pretendohet se ato kanë për argumentet e Prokurorisë.⁴⁸ Të njëjtat kushte dhe kriteret pranimi, të përcaktuara në rregullën 138(1), zbatohen për të gjitha kategoritë e provave materiale të propozuara, pavarësisht rëndësisë (së perceptuar) të tyre për argumentet e një pale.⁴⁹ Me rëndësi është që pala që i paraqet provat të bindë Trupin Gjyqësor për relevancën *prima facie*, autenticitetin dhe vlerën provuese të materialeve të paraqitura në bazë të rregullës 138(1). Gjithashtu, Trupi Gjyqësor vëren se kanë mbetur edhe pak dëshmitarë që do të thirren për të dëshmuar në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në Zonën Operative të Llapit në kohën për të cilën është fjala, dhe se aktualisht është treguar se këta dëshmitarë do ta ndihmojnë procesin e pranimi të cilitdo prej dokumenteve që lidhen me këtë kërkesë.

22. Megjithatë, Trupi Gjyqësor rikujton se mocionet për pranimin e provave jogojore nuk duhet të përdoren si mënyrë për ta bërë të parëndësishëm parimin e dhënies së dëshmisë gojore në një proces gjyqësor. Ndonëse procedura e pranimi të provave jogojore është në interes të administrimit efikas të procesit dhe ndihmon për të përshpejtuar procesin e pranimi të provave, ajo nuk duhet të shndërrohet në alternativë të paraqitjes së provave materiale më të rëndësishme përmes dëshmitarëve që janë në gjendje të flasin për to dhe të merren në pyetje për to nga pala jothirrëse. Edhe kur një provë materiale e propozuar pranohet si provë jogojore, pala që e paraqet duhet të konsiderojë përdorimin e saj në gjykatë me dëshmitarin ose dëshmitarët përkatës, kur kjo përligjet për ta kuptuar më mirë

⁴⁷ Shih Vendimin e Parë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 12. Shih gjithashtu rregullën 138(1). Shih Përgjigjen, para. 13, 15-18; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.1, C.1.3, C.3, C.3.2 dhe C.13.

⁴⁸ Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 84. Shih Përgjigjen, para. 14, 38; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet R.3.

⁴⁹ Vendimi i Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 92.

dokumentin dhe vendin që ai zë në argumentet e palës.⁵⁰ Gjithashtu, përdorimi i provave materiale të propozuara gjatë dëshmive të dëshmitarëve mund të ofrojë kontekst të vlefshëm që lidhet, për shembull, me peshën ose mbështetshmërinë e asaj prove materiale.⁵¹

23. Trupi Gjykes tani do të trajtojë argumentet e Mbrojtjes në lidhje me veçoritë e provave materiale të propozuara.⁵² Së pari, Trupi Gjykes rikujton se ndonëse do të ndihmonte për të përcaktuar kriteret për pranimin e provave, vërtetimi i prejardhjes ose autorësisë së materialeve të paraqitura nuk është rreptësisht i nevojshëm kur vlerësohet autenticiteti dhe mbështetshmëria *prima facie* sipas rregullës 138(1).⁵³ Megjithatë, Trupi Gjykes rikujton se disa kategorive të dokumenteve, ndër të cilat dhe dokumentet e shkruara me dorë, që nuk kanë tregues të burimit apo tregues të tjerë të prejardhjes, mund t'u mungojnë treguesit e mbështetshmërisë që nevojiten për pranimin e tyre si prova, përveç nëse ato përmbajnë tregues të tjerë relevantë të mbështetshmërisë së tyre.⁵⁴ Fakti që në një dokument nuk përmendet burimi i tij ose që ai është i shkruar me dorë, nuk nënkupton se nuk mund të ketë tregues të tjerë për të kuptuar se kush është autori i tij, apo se cili është burimi i tij. Për pranimin si provë pyetja që shtrohet është nëse dokumenti në fjalë i përmbush apo jo kriteret e rregullës 138(1).

24. Në mënyrë të ngjashme, fakti që materialet e paraqitura ofrohen si pjesë e grupeve voluminoze të dokumenteve, ku përfshihen dhe fotografi dhe videoincizime, të cilat nganjëherë nuk kanë lidhje të dallueshme me njëri-tjetrin, nuk është pengesë për pranimin e tyre, me kusht që të konstatohet se secili prej

⁵⁰ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 16.

⁵¹ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 17.

⁵² *Shih më lart* paragrafin 19(a)-(f).

⁵³ Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 82. *Shih* Përgjigjen, para. 19-27, 30-32; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.6 dhe C.12.

⁵⁴ Vendimi mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 59, që i referohet ICTY, *Prosecutor v. Mladić*, IT-09-92-T, [Decision on Defence's Fifth Motion for the Admission of Documents from the Bar Table \(Vendim mbi Mocionin e Pestë për Pranimin e Dokumenteve si Prova Jogojore\)](#), 30 maj 2016, para. 23.

materialeve të paraqitura për pranim është *prima facie* relevant, autentik, me vlerë provuese dhe nuk i shkakton dëm të papërligjur Mbrojtjes.⁵⁵

25. Në lidhje me provat materiale të propozuara që pretendohet se përmbajnë dokumente dëshmesh,⁵⁶ Trupi Gjykses mban parasysh dhe pranon argumentin e ZPS-së se asnjë prej tyre nuk përbën ose përmban deklarata apo transkripte intervistash të përgatitura në kuadër të procedurave ligjore, apo ofrohet për vërtetësinë e përmbajtjes së tij.⁵⁷ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara, të kundërshtuara prej Mbrojtjes për shkak të natyrës dëshmuese të pretenduar të tyre, nuk janë objekt i rregullave 153-155.⁵⁸

26. Së fundi, në lidhje me kundërshtimet e Mbrojtjes së Selimit ndaj provave materiale të propozuara që u sekuestruan në banesën e z. Selimi,⁵⁹ Trupi Gjykses rikujton konstatimin e tij në Vendimin e Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore në lidhje me ligjshmërinë e operacioneve të kontrollimit dhe sekuestrimit, që u konfirmua prej Panelit të Gjykatës së Apelit.⁶⁰ Mbrojtja nuk ka kërkuar rishikim, e as nuk ka vërtetuar se ndonjë prej aspekteve për të cilat u vendos në Vendimin e Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, ka nevojë të rishikohet në bazë të rregullës 79.

27. Trupi Gjykses do të vlerësojë nëse provat materiale të propozuara janë të pranueshme në bazë të rregullës 138. Për këtë, Trupi Gjykses do t'u referohet provave materiale të propozuara të renditura me numra në Shtojcën 1 të Mocionit dhe Shtojcën 1 të Përgjigjes.

⁵⁵ *Krahaso me* Vendimin e Tretë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 36. *Shih* Përgjigjen, para. 28-29; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet C.1, C.1.3, C.4, C.8, C.11, C.12 dhe C.13.

⁵⁶ Përgjigja, para. 33-35; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet C.8.

⁵⁷ *Shih* Kundërpërgjigjen, poshtëshënimin 20.

⁵⁸ *Krahaso me* Vendimin e Gjashtë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 126.

⁵⁹ Përgjigja, para. 36; Shtojca 1 e Përgjigjes, kundërshtimet C.2.

⁶⁰ Vendimi i Dytë mbi Mocionin për Pranimin e Provave Jogojore, para. 101-120; IA029/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Veselit dhe Krasniqit kundër Vendimit të Dytë mbi Mocionin e Prokurorit të Specializuar për Pranimin e Provave Jogojore*, 23 gusht 2023, konfidencial dhe *ex parte*, para. 32, 36-38 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, IA029/F00005/RED).

3. Provat materiale të propozuara 1-77: organizimi i UÇK-së në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999

28. Fillimisht, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në të bëjë korrigjime në meta të dhënat e provës materiale të propozuar 9.⁶¹

29. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se provat materiale të propozuara 17, 28 dhe 49 janë pranuar përkatësisht si provat P01762, P01763 dhe P01761, pas dorëzimit të Mocionit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 17, 28 dhe 49.

(a) Relevanca

30. Lidhur me relevancën e provave materiale të propozuara 1-77, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja parashtrohet se ato lidhen me organizimin e UÇK-së në vitin 1998 dhe fillimin e vitit 1999.⁶² Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) provat materiale të propozuara 1-13 përbëhen nga vendime që lidhen me emërimin e zyrtarëve të lartë në Zonën Operative të Llapit, si dhe në Brigadat 151 dhe 152 ("vendimet e emërimit"); (ii) provat materiale të propozuara 14-20 përbëhen nga lista të individëve të inkuadruar në Zonën Operative të Llapit nga UÇK-ja në vitin 1998 ("dokumentet e inkuadrimit"); (iii) provat materiale të propozuara 21-29 përbëhen nga udhëzime dhe dokumente që lidhen me oraret e kujdestarisë dhe detyrat e shërbimit të rojës ("oraret e kujdestarisë"); (iv) provat materiale të propozuara 30-36 përbëhen nga shënime, raporte dhe memorandume të UÇK-së, që mbulojnë periudhën ndërmjet qershorit 1998 dhe prillit 1999 ("memorandumet"); (v) provat materiale të propozuara 37-41 përbëhen nga dokumente dhe formularë të standardizuar të përdorur prej UÇK-së

⁶¹ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 6(d).

⁶² *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 1-39, Provat materiale të propozuara 1-77.

(“formularët”); (vi) provat materiale të propozuara 42-54 përbëhen nga dokumente, plane dhe programe që lidhen me veprimtaritë trajnuese të UÇK-së (“dokumentet e trajnimit”); (vii) provat materiale të propozuara 55-61 përbëhen nga dokumente mbi financat, armatimin në zotërim dhe furnizimet e Zonës Operative të Llapit, si dhe me kodet e komunikimit (“dokumentet logjistike”);⁶³ dhe (viii) provat materiale të propozuara 62-77 përfshijnë urdhra të UÇK-së që kanë të bëjnë kryesisht me disa aspekte civile (“urdhrat në lidhje me aspekte civile”).

31. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në prova materiale të propozuara që lidhen me organizimin e UÇK-së në vitin 1998 dhe fillimin e vitit 1999, për të faktuar, ndër të tjera, se: (i) në gusht 1998, një delegacion i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së (“Shtabi i Përgjithshëm”), në të cilin përfshiheshin Hashim Thaçi (“z. Thaçi”), Rexhep Selimi (“z. Selimi”) dhe Jakup Krasniqi (“z. Krasniqi”), vizitoi Zonën Operative të Llapit dhe lëshoi vendime zyrtare emërimi me shkrim për anëtarë të komandës së Zonës Operative të Llapit (“komanda e zonës”), përfshirë shefin e zbulimit Latif Gashi;⁶⁴ (ii) komanda e Zonës Operative të Llapit mbante takime, ishte përgjegjëse për të gjitha njësitet e UÇK-së në Zonën Operative të Llapit, mbante kontakte të shpeshta me komandantët në vartësi të saj dhe me zonat e tjera, dhe ishte në kontakt me Shtabin e Përgjithshëm (përfshirë të akuzuarit), bënte raporte dhe merrte urdhra, udhëzime dhe rregullore;⁶⁵ dhe (iii) afërsisht nga qershori 1998, në bazë të urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm, komanda e Zonës Operative të Llapit mori masa për rekrutimin, stërvitjen dhe dislokimin në terren të ushtarëve të rinj, si dhe për zgjerimin dhe konsolidimin e strukturave komanduese.⁶⁶ Gjithashtu, ZPS-ja

⁶³ Trupi Gjykues vëren se ZPS-ja paraqet për pranim vetëm faqet U001-0243-U001-0244 të versionit origjinal të provës materiale të propozuar 59. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 30 (prova materiale e propozuar 59).

⁶⁴ Mocioni, para. 3.

⁶⁵ Mocioni, para. 4.

⁶⁶ Mocioni, para. 5.

mbështetet në provat materiale të propozuara që lidhen me organizimin e UÇK-së në vitin 1998 dhe fillimin e vitit 1999 sa i përket: (i) ekzistencës, strukturës dhe raporteve ndërmjet mbrojtjes territoriale, shërbimeve të zbulimit dhe policisë ushtarake; (ii) armatimeve, mobilizimit dhe furnizimeve; (iii) orareve të shërbimit të rojës; (iv) programeve të stërvitjes të UÇK-së; (v) disiplinimit dhe mbajtjes në ndalim të ushtarëve të UÇK-së për mosbindje; dhe (vi) arrestimit të atyre që pretendohet se ishin bashkëpunëtorë.⁶⁷

32. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 1-16, 18-27, 29-48, dhe 50-77, Trupi Gjykses është bindur se secila prej tyre dhe të gjitha së bashku janë *prima facie* relevante për pretendimet dhe akuzat e përfshira në Aktakuzë⁶⁸ si dhe për dëshmitë e disa dëshmitarëve.⁶⁹

(b) Autenticiteti

33. Lidhur me autenticitetin, Trupi Gjykses thekson se, ndonëse jo të gjitha vendimet e emërimit janë të nënshkruara,⁷⁰ ato kanë mbishkrimin UÇK në krye të tyre dhe/ose emblemën e saj, dhe në to përmendet data konkrete dhe/ose Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues i tyre.⁷¹ Thelbi dhe përmbajtja e tyre është gjithashtu tregues i burimit të tyre. Gjithashtu, një prej vendimeve të emërimit mban vulën e UÇK-së dhe është i nënshkruar,⁷² ndërsa nëntë prej tyre duket se janë nënshkruar nga zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Llapit, Kadri Kastrati ("Daja").⁷³ Trupi Gjykses është i mendimit se argumenti i Mbrojtjes se numri i brigadës që përmendet në provën materiale të propozuar 12 është i gabuar,

⁶⁷ Mocioni, para. 5-13.

⁶⁸ *Shih p.sh.* F00999/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar ("Aktakuza")*, 30 shtator 2022, konfidenciale, para. 18-55, 70-73, 75, 106-109, 155, 157-158, 160. *Shih* Përgjigjen, para. 5, 28, 32; Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet R.1, R.2 dhe R.2.1.

⁶⁹ *Shih p.sh.* W04758-ën dhe W04485-ën.

⁷⁰ Provat materiale të propozuara 1, 12-13.

⁷¹ Provat materiale të propozuara 1-13.

⁷² Prova materiale e propozuar 2.

⁷³ Provat materiale të propozuara 3-11.

ka të bëjë me peshën provuese që duhet t'i jepet kësaj prove prej Trupit Gjykses në fund të gjykimit duke marrë parasysh tërësinë e provave, e jo me pranueshmërinë e saj.⁷⁴ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se vendimet e emërimit kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

34. Në lidhje me dokumentet e inkuadrimit, Trupi Gjykses thekson se ato përmbajnë të dhënat personale dhe datat e inkuadrimit në UÇK të një numri individësh, si dhe zonat e tyre të përgjegjësisë, batalionin ku janë caktuar ose komunën/fshatin nga kanë ardhur.⁷⁵ Gjithashtu, prova materiale e propozuar 17 duket se është e nënshkruar prej ushtarëve të inkuadruar dhe, në emër të UÇK-së, kryesisht nga komandanti i Brigadës 151, Nuredin Ibishi ("Leka"). Në mënyrë të ngjashme, edhe një pjesë e provës materiale të propozuar 18 duket se është e nënshkruar prej komandant Lekës.⁷⁶ Trupi Gjykses gjithashtu thekson se pjesë të provës materiale të propozuar 18 si dhe prova materiale e propozuar 21 janë diskutuar gjerësisht dhe autenticiteti i tyre është konfirmuar prej W04758-ës gjatë dëshmisë së tij.⁷⁷ Trupi Gjykses gjithashtu thekson se fakti që disa individë të përmendur në provën materiale të propozuar 15 ishin anëtarë të Brigadës 151, duket se përkon me informacionin e ngjashëm që përmban prova materiale e propozuar 17. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet e inkuadrimit kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

35. Në lidhje me oraret e kujdestarisë, Trupi Gjykses vëren se ato kanë data, janë të nënshkruara prej komandantëve të Zonës Operative të Llapit, përfshirë zëvendëskomandantin Kadri Kastrati ("Daja"), dhe/ose përmbajnë oraret e shërbimit të rojës dhe shërbimeve të tjera, veprimtaritë ditore të zakonshme të

⁷⁴ Shih Shtojcën 1 të Përgjigjes, f. 11-12 (prova materiale e propozuar 12).

⁷⁵ Provat materiale të propozuara 14-20.

⁷⁶ Prova materiale e propozuar 18, f. 11.

⁷⁷ Transkripti i seancës, 23 tetor 2024, f. 21036-21039.

planifikuara për periudha të ndryshme në vitin 1998, dhe emrat e ushtarëve përkatës.⁷⁸ Veç kësaj, provat materiale të propozuara 28 dhe 29 kanë mbishkrimin UÇK në krye. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se oraret e kujdestarisë kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

36. Në lidhje me memorandumet, Trupi Gjykses vëren se, ndonëse disa prej tyre janë të shkruar me dorë,⁷⁹ ato: (i) kanë datë; (ii) burojnë nga Zona Operative e Llapit ose i referohen asaj; dhe (iii) në to flitet për ngjarje ose emërtime vendndodhjesh dhe emra individësh përkatës të asaj kohe,⁸⁰ përfshirë komandantin e Brigadës 151 Nuredin Ibishi ("Leka"), komandantin e Zonës Operative të Llapit Rustem Mustafa (Remi"), dhe zëvendëskomandantin Kadri Kastrati ("Daja").⁸¹ Gjithashtu, provat materiale të propozuara 35-36 kanë fjalët UÇK në krye dhe përmbajnë dokumente që janë të nënshkruara prej komandantit të Brigadës 153 Adem Shehu dhe zëvendëskomandantit Sejdi Veseli. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentin e ZPS-së se prova materiale e propozuar 57 përmban të dhëna të ngjashme me ato të përfshira në provën materiale të propozuar 34.⁸² Ndonëse përputhja që kanë në thelb disa dokumente mes tyre nuk është domosdoshmërisht provë e autenticitetit të tyre, ajo mund të jetë tregues i rëndësishëm i burimit të tyre, siç është rasti me këto dy materiale. Trupi Gjykses gjithashtu konsideron se prova materiale e propozuar 36 përbëhet nga një version me cilësi më të mirë teksti të faqeve 2-3 të provës materiale të propozuar 35, si dhe provës materiale të pranuar P00170.⁸³ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se memorandumet kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

⁷⁸ Provat materiale të propozuara 21-29.

⁷⁹ Provat materiale të propozuara 30-31, 33-34.

⁸⁰ Provat materiale të propozuara 30-36.

⁸¹ Provat materiale të propozuara 32, 34.

⁸² Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 33.*

⁸³ Kundërpërgjigja, para. 6(b).

37. Në lidhje me formularët, Trupi Gjykses vë në dukje se provat materiale të propozuara 37, 39 dhe 40-41, kanë mbishkrimin UÇK në krye, vulën e hijezuar ose shenjën e UÇK-së, ndërsa prova materiale e propozuar 38 duket se ka nënshkrimin e komandantit të Brigadës 151 Nuredin Ibishi ("Leka"). Gjithashtu, provat materiale të propozuara 39 dhe 41 përmbajnë dokumente me data dhe në provën materiale të propozuar 40 evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se provat materiale të propozuara 38-41 janë të mbushura me të dhëna personale të ushtarëve të përmendur me emër. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se formularët kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentikë.

38. Në lidhje me dokumentet e trajnimit, Trupi Gjykses thekson se ato përbëhen nga dokumente që përmbajnë referenca për: (i) veprimtaritë e stërvitjes ushtarake;⁸⁴ (ii) taktikat e luftës;⁸⁵ (iii) ushtrimet ushtarake;⁸⁶ (iv) elementet e luftës guerile efektive;⁸⁷ (v) përbërjen e shtabeve të UÇK-së në kohë paqeje dhe lufte;⁸⁸ (vi) njësitet dhe strukturat ushtarake;⁸⁹ (vii) komponentët e Brigadës Alpine të UÇK-së dhe udhëzimet mbi përdorimin e armëve të artilerisë;⁹⁰ dhe (viii) planet e veprimit për garantimin e sigurisë.⁹¹ Trupi Gjykses është i mendimit se, duke pasur parasysh kontekstin dhe përmendjen në këto dokumente të shtabeve dhe zonave operative, si dhe të strukturave të ngritura në territoret e UÇK-së, dokumentet e trajnimit, *prima facie*, duket se burojnë nga UÇK-ja. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh argumentin e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 42, 43-44 dhe 47 përmbajnë informacion përgjithësisht të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 49, 52 dhe

⁸⁴ Provat materiale të propozuara 42-43, 49.

⁸⁵ Prova materiale e propozuar 45.

⁸⁶ Prova materiale e propozuar 46.

⁸⁷ Provat materiale të propozuara 44, 47, 53.

⁸⁸ Prova materiale e propozuar 50.

⁸⁹ Prova materiale e propozuar 51.

⁹⁰ Prova materiale e propozuar 52.

⁹¹ Provat materiale të propozuara 48, 54.

53, duke ofruar kështu një shkallë mbështetjeje në lidhje me burimin dhe prejardhjen e atij materiali; (ii) përmbajtja e provave materiale të propozuara 43, 45 dhe 49 përkon me atë të provës materiale të pranuar P00187; dhe (iii) prova materiale e propozuar 53 i referohet informacionit mbi njësitet speciale të Zonës Operative të Llapit, ku për këto njësitet speciale u diskutua gjatë dëshmisë së W04746-ës.⁹² Trupi Gjykses gjithashtu thekson se provat materiale të propozuara 43 dhe 49 janë të nënshkruara dhe në to evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet e trajnimit kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

39. Në lidhje me dokumentet logjistike, Trupi Gjykses vëren se ato përbëhen nga dokumente që përmbajnë referenca për: (i) financat;⁹³ (ii) armatimin në zotërim;⁹⁴ (iii) armët dhe veshmbathjet e dhëna;⁹⁵ (iv) furnizimin me armë;⁹⁶ dhe (v) kodet e komunikimit me radio dhe udhëzimet në lidhje me hartimin e një plani të komunikimit.⁹⁷ Trupi Gjykses është i mendimit se, duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre, dokumentet logjistike, *prima facie*, duket se burojnë nga UÇK-ja. Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh se: (i) provat materiale të propozuara 55 dhe 58 kanë datë dhe janë të nënshkruara; (ii) provat materiale të propozuara 55-56 dhe 58 kanë mbishkrimin UÇK në krye të tyre dhe/ose emblemën e saj; (iii) në provat materiale të propozuara 55-56 dhe 58-59 evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues; (iv) ZPS-ja parashtron se prova materiale e propozuar 57 ka informacion që përkon me informacionin që përmban prova materiale e propozuar 34, çka është tregues i mëtëjshëm i burimit të saj; dhe (v)

⁹² Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu* transkriptin e seancës, 11 korrik 2023, f. 5505-5506.

⁹³ Prova materiale e propozuar 55.

⁹⁴ Prova materiale e propozuar 56.

⁹⁵ Provat materiale të propozuara 57, 59. Trupi Gjykses rikujton se ZPS-ja paraqet për pranim vetëm faqet U001-0243-U001-0244 të versionit origjinal të provës materiale të propozuar 59. *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 30 (prova materiale e propozuar 59). *Shih më lart* poshtëshënimin 63.

⁹⁶ Prova materiale e propozuar 58.

⁹⁷ Provat materiale të propozuara 60-61.

hartimi i provës materiale të propozuar 61 përshkruhet në provën materiale të pranuar P00187.⁹⁸ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet logjistike kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

40. Sa u përket urdhrave në lidhje me çështjet civile, Trupi Gjykses thekson se provat materiale të propozuara 62-63 dhe 65-77: (i) kanë mbishkrimin UÇK në krye të tyre dhe/ose emblemën e saj; (ii) në to tregohet data, vendi i lëshimit dhe/ose numri i referencës; dhe (iii) në to evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues. Veç kësaj: (i) provat materiale të propozuara 63, 66 dhe 70 duket se janë të nënshkruara nga komandanti i Zonës Operative të Llapit Rustem Mustafa ("Remi"); (ii) provat materiale të propozuara 65, 67-69 dhe 73 duket se janë të nënshkruara nga zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Llapit Kadri Kastrati ("Daja"); dhe (iii) prova materiale e propozuar 73 u sekuestrua nga ZPS-ja në banesën e z. Selimi.⁹⁹ Trupi Gjykses mban parasysh edhe argumentet e ZPS-së se: (i) në provën materiale të propozuar 64 përmendet informacion që ka natyrë të ngjashme me atë që përmbajnë provat materiale të propozuara 67-69; dhe (ii) provat materiale të propozuara 72 dhe 74-76 përmbajnë urdhra të një natyre dhe formati të ngjashëm me ato të përfshira në provat materiale të propozuara 112-121.¹⁰⁰ Siç u theksua më lart, këto ngjashmëri dhe përkime janë tregues i mëtejshëm i prejardhjes dhe burimit të këtij informacioni. Për këto arsye, Trupi

⁹⁸ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 36.*

⁹⁹ *Shih* F00030, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Autorizimin e Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 26 tetor 2020, konfidencial; F00100, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë mbi Kontrollimin dhe Sekuestrimin në zbatim të Vendimit KSC-BC-2020-06-F00030*, 23 nëntor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00214, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë mbi Rishikimin e Materialeve të Sekuestruara në përputhje me Vendimet KSC-BC-2020-06/F00028, KSC-BC-2020-06/F00029, KSC-BC-2020-06/F00030 dhe KSC-BC-2020-06/F00031*COR, 11 mars 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*; F00366, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Indekseve të Materialeve të Sekuestruara*, 23 qershor 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 26.*

¹⁰⁰ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më poshtë, paragrafin 50.*

Gjykues është bindur se urdhrat në lidhje me aspekte civile kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

41. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 1-16, 18-27, 29-48 dhe 50-77 janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

42. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 1-77 janë *prima facie* relevante dhe autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje, siç përshkruhet më lart në paragrafin 31.¹⁰¹

43. Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e provave materiale të propozuara 1-16, 18-27, 29-48 dhe 50-77 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre, duke marrë parasysh se Mbrojtja mund të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje si palë jothirrëse të dëshmitarëve përkatës, si dhe përmes paraqitjes së provave, nëse zgjedh ta bëjë këtë.

(d) Përfundim

44. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 1-16, 18-27, 29-48 dhe 50-77 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).¹⁰²

¹⁰¹ Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet U001-0243-U001-0244 të provës materiale të propozuar 59, dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 63, 95.

¹⁰² Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar vetëm faqet U001-0243-U001-0244 të provës materiale të propozuar 59, dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 63, 95, 101.

4. Provat materiale të propozuara 78-131: qëllimi kriminal i përbashkët i pretenduar në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999

45. Fillimisht, Trupi Gjykses thekson se prova materiale e propozuar 107 është pranuar si prova materiale P01046 pas dorëzimit të Mocionit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e provës materiale të propozuar 107.¹⁰³

(a) Relevanca

46. Lidhur me relevancën e provave materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja parashtro se ato lidhen me qëllimin e kriminal të përbashkët të pretenduar të UÇK-së në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999.¹⁰⁴ Në këtë aspekt, Trupi Gjykses vë në dukje se: (i) provat materiale të propozuara 78-79, 82-83, 88-89, 98, 100-101, 103, 108-109, 111, 124,¹⁰⁵ 127-128 dhe 130 përbëhen nga shënime me shkrim dore dhe të daktilografuara, grumbuj raportesh, rrëfime, ditarë dhe faqe fletorësh me shënime për punën e shërbimeve të zbulimit të Llapit dhe mbrojtjes territoriale, ku përfshihen dhe emrat e atyre që dyshohej se ishin bashkëpunëtorë dhe evidencat e personave të ndaluar (“shënimet”); (ii) provat materiale të propozuara 80-81, 112-122,¹⁰⁶ dhe 125-126 përbëhen nga dokumente zyrtare të UÇK-së që përmbajnë, përkatësisht, vendime në lidhje me ndalimet për

¹⁰³ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 6(a).

¹⁰⁴ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 39-100, Provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131.

¹⁰⁵ Trupi Gjykses vë në dukje se faqet 1-2, 40-51 të provës materiale të propozuar 124 tashmë janë pranuar si prova P00738. Trupi Gjykses e deklaron të tejkaluar kërkesën për pranimin e këtyre faqeve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka vlerësuar vetëm faqet e mbetura të provës materiale të propozuar 124 dhe përkthimin përkatës.

¹⁰⁶ Trupi Gjykses thekson se ZPS-ja parashtro se “paraqet për pranim vetëm faqet e versionit original të provës materiale të propozuar 121 që janë përkthyer (me përjashtim të U000-9107 dhe U000-9108)” (Shtojca 1 e Mocionit, f. 85 (prova materiale e propozuar 121)). Duke pasur parasysh se U000-9107 nuk është përkthyer dhe se U000-9108 është përkthyer dhe është përfshirë prej ZPS-së në kolonën “relevanca/vlera provuese” për provën materiale të propozuar 121, dhe duke marrë parasysh se U000-9125 nuk është përkthyer dhe asaj ZPS-ja nuk i është referuar, Trupi Gjykses nxjerr përfundimin se prova materiale e propozuar 121 përbëhet prej faqeve U000-9108-U000-9124 dhe përkthimit përkatës.

arsye disiplinore të një numri ushtarësh, urdhra në lidhje me veprimtaritë civile, dhe një vendim amnistie për lirim të disa të ndaluarve (“vendimet dhe urdhrat”); (iii) provat materiale të propozuara 84-87, 90-92, 97, 99, 102, 104-106 dhe 110 përbëhen nga deklaratat të bashkëpunëtorëve të pretenduar të shkruara me shkrim dore (“deklaratat”); (iv) provat materiale të propozuara 93-96 përbëhen nga procesverbale dhe analiza e hetimeve të kryera prej UÇK-së ndaj personave që konsideroheshin si bashkëpunëtorë (“procesverbalet dhe analiza e hetimeve”); (v) provat materiale të propozuara 123 dhe 131 përbëhen nga dokumente që përmbajnë, përkatësisht, lista të anëtarëve të LDK-së dhe policëve serbë (“listat”); dhe (vi) prova materiale e propozuar 129 është një dokument zyrtar i UÇK-së që përmban një letërnjoftim të lëshuar nga Latif Gashi (“letërnjoftimi”).

47. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131 për të faktuar se komandat e brigadave dhe njësitë vartëse, duke vepruar së bashku me komandën e Zonës Operative të Llapit, shërbimin e zbulimit dhe policinë ushtarake, mbledhnin informacion dhe ishin të përfshirë në arrestimet, ndalimet, keqtrajtimet dhe marrjet në pyetje të, ndër të tjerë, romëve dhe serbëve si dhe të bashkëpunëtorëve të pretenduar.¹⁰⁷

48. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131, Trupi Gjykses është bindur se të gjitha këto materiale lidhen me ngjarjet që ndodhën në Zonën Operative të Llapit në vitin 1998 dhe fillim të vitit 1999, të cilat janë mjaftueshëm të lidhura me pretendimet dhe akuzat e përfshira në Aktakuzë¹⁰⁸ si dhe me disa dëshmi të dëshmitarëve.¹⁰⁹ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131 janë *prima facie* relevante.

¹⁰⁷ Mocioni, para. 13.

¹⁰⁸ *Shih p.sh.* Aktakuzën, para. 18-55, 70-73, 75, 106-109, 155, 160. *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet R.1.

¹⁰⁹ *Shih p.sh.* W04287-ën, W04601-shin dhe W04758-ën.

(b) Autenticiteti

49. Sa i përket autenticitetit, Trupi Gjykses vëren se shënimet përbëhen nga dokumente të shkruara me dorë dhe të daktilografuara, në të cilat përmenden data, vendndodhje, individë/bashkëpunëtorë të dyshuar, ngjarje dhe/ose përshtkrime të punës dhe veprimtarisë së UÇK-së. Gjithashtu: (i) në provat materiale të propozuara 78 dhe 125 evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues; (ii) provat materiale të propozuara 79, 88, 98 dhe 128 përmbajnë nënshkrime të individëve nga Zona Operative e Llapit, ndër të cilët zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Llapit Kadri Kastrati ("Daja"); (iii) në provën materiale të propozuar 109 përmendet komandanti i Zonës Operative të Llapit Rrustem Mustafa ("Remi") dhe zëvendëskomandanti Kadri Kastrati ("Daja") si dhe Muhamet Latifi, komandant i mbrojtjes territoriale dhe më vonë i policisë ushtarake në Zonën Operative të Llapit; dhe (iv) prova materiale e propozuar 125 ka mbishkrimin UÇK në krye dhe numër reference. Trupi Gjykses gjithashtu thekson se: (i) faqja 4 e provës materiale të propozuar 83 dhe faqja 11 e provës materiale të propozuar 124 iu treguan W04422-shit gjatë dëshmisë së tij dhe u shtjelluan prej tij;¹¹⁰ (ii) prova materiale e propozuar 114 iu tregua W04758-ës gjatë dëshmisë së tij dhe ajo u shtjellua prej tij;¹¹¹ (iii) pjesë të provës materiale të propozuar 127 u shtjelluan prej W04651-shit gjatë dëshmisë së tij dhe ai konfirmoi autenticitetin e saj;¹¹² dhe (iv) faqet 5-6 të provës materiale të propozuar 130 u shtjelluan prej W04669-ës gjatë dëshmisë së tij dhe ai konfirmoi autenticitetin e saj.¹¹³ Trupi Gjykses është i mendimit se, duke pasur parasysh përmbajtjen e tyre,

¹¹⁰ Transkripti i seancës, 25 shtator 2024, f. 20218-20222, konfidencial. *Shih* P01679 MFI. Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet 3-39, 52-60 të provës materiale të propozuar 124 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimin 105.

¹¹¹ Transkripti i seancës, 23 tetor 2024, f. 21050-21052.

¹¹² Transkripti i seancës, 26 gusht 2024, ff. 18908-18917. *Shih* P01553 MFI.

¹¹³ Transkripti i seancës, 26 shtator 2024, f. 20355-20356, konfidencial. *Shih* P01687 MFI. Trupi Gjykses vëren se ka marrë parasysh parashtrimet e mëtejshme, ose mungesën e tyre, mbi autenticitetin e P01687 MFI të paraqitura prej ZPS-së dhe Mbrojtjes në tre parashtrime të protokolluara të veçanta: F02667, Prokurorja e Specializuar, *Mocion i Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Nerodimes ("F02667")*, 21 tetor 2024, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale, para. 19-20 (versioni i redaktuar

shënimet duket se burojnë nga UÇK-ja. Trupi Gjykses gjithashtu merr parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 79, 82-83, 88-89, 98, 100-101, 103, 108-109, 124 dhe 127-128 përmbajnë informacion që përkon dhe/ose informacion të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 14-15, 20, 33, 78, 81, 85-87, 90-97, 99, 102, 104, 110, 126 dhe 129, dhe ky përkim është tregues i mëtejshëm i prejardhjes dhe burimit të materialit në fjalë;¹¹⁴ dhe (ii) edhe në provat materiale të propozuara 79, 82-83, 88-89, 98, 108-109, 124, 127 dhe 130 përmenden emra dhe fakte të referuara në prova materiale të tjera të pranuar apo në fakte tashmë të konstatuara në kuadër të proceseve të tjera dhe/ose të shtjelluara prej dëshmitarëve përkatës gjatë dëshmive të tyre.¹¹⁵ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se shënimet kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

50. Lidhur me vendimet dhe urdhrat, Trupi Gjykses vëren se ato përmbajnë mbishkrimin UÇK në krye dhe/ose emblemën e saj, janë të nënshkruara (përfshirë prej zëvendëskomandantit të Zonës Operative të Llapit Kadri Kastrati ("Daja"), dhe në to evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 80-81 dhe 112-122 kanë data, ndërsa provat materiale të propozuara 112-122 dhe 126 kanë numër reference dhe në provat

publik u dorëzua më 11 nëntor 2024, F02667/RED); F02725, Mbrojtësi i Specializuar, *Përgjigje e Përbashkët e Mbrojtjes ndaj Mocionit të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Nerodimes si Prova Jogoje dhe Kërkesa në lidhje me Të (F02667)*, 15 nëntor 2024, konfidenciale, me Shtojcën 1, konfidenciale, para. 30-31 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 nëntor 2024, F02725/RED); F02746, Prokurorja e Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë në lidhje me Mocionin për Pranimin e Dokumenteve të Zonës së Nerodimes (F02667)*, 22 nëntor 2024, konfidenciale, para. 7 (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 25 nëntor 2024, F02746/RED).

¹¹⁴ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart para. 34, 36, dhe më poshtë para. 50, 51-52, 54.*

¹¹⁵ Shtojca 1 e Mocionit, *që i referohet*, në pjesët përkatëse, P00010; P00104; P00226; P00738; P00882; P00959; P00960; P01046; 1D00007; Transkriptit të seancës, 19 qershor 2023, f. 5028-5030; Transkriptit të seancës, 12 korrik 2023, f. 5515-5519, 5586, 5592-5594; Transkriptit të seancës, 13 korrik 2023, f. 5616; Transkriptit të seancës, 11 dhjetor 2023, f. 10916, 10947; Transkriptit të seancës, 29 janar 2024, f. 12004-12013, 12018-12019, 12024, 12044; Transkriptit të seancës, 30 janar 2024, f. 12138. *Shih gjithashtu F02667, para. 20, poshtëshënimin 92, që i referohet provave P01645; P01680; Fakteve të konstatuara 780, 812, 847, 849, 853, 855, 861, 864, 866, 868-870, 874, 876, 879-881, 885, 887-889, 893-895, 898-899, 936-937; Transkriptit të seancës, 26 shtator 2024, f. 20348, konfidencial.*

materiale të propozuara 80 dhe 112-122 specifikohet vendi i lëshimit të tyre. Trupi Gjykses gjithashtu vëren se ZPS-ja parashtron se: (i) në provat materiale të propozuara 80-81 përmenden detaje që përkojnë me ato të përfshira në provat materiale të propozuara 79, 83 dhe 124;¹¹⁶ (ii) provat materiale të propozuara 112-122 përmbajnë urdhra të një natyre dhe formati të ngjashëm me njëri-tjetrin dhe me ato të përfshira në provat materiale të propozuara 72 dhe 74-76;¹¹⁷ (iii) prova materiale e propozuar 126 përmban informacion që përkon me atë të përfshirë në provat materiale të propozuara 83, 103-104, 108 dhe 124 – që është tregues i mëtejshëm i burimit dhe prejardhjes;¹¹⁸ dhe (iv) në provën materiale të propozuar 126 përmenden emra dhe fakte të referuara edhe në prova materiale të tjera të pranuar dhe/ose të shtjelluara prej dëshmitarëve përkatës gjatë dëshmive të tyre.¹¹⁹ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se vendimet dhe urdhrat kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

51. Në lidhje me deklaratat, Trupi Gjykses thekson se ato përbëhen nga dokumente që përmbajnë përshkrime të hollësishme të ngjarjeve që kanë ndodhur në Zonën Operative të Llapit në vitin 1998. Gjithashtu: (i) provat materiale të propozuara 84-87 kanë data; dhe (ii) provat materiale të propozuara 86-87, 90, 99 dhe 104-105 janë të nënshkruara. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 84-87, 90-92, 97, 99, 102, 104, 106 dhe 110 përmbajnë informacion që përkon dhe/ose informacion të një lloji të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 79, 81, 83, 88-89, 93-96, 98, 103, 105, 108, 124 dhe 126-127, çka është

¹¹⁶ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart para. 49.*

¹¹⁷ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart para. 40.* Trupi Gjykses rikujton se është në dijeni se prova materiale e propozuar 121 përbëhet nga faqet U000-9108-U000-9124 dhe përkthimet përkatëse. *Shih më lart poshtëshënimin 106.*

¹¹⁸ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 49 dhe më poshtë paragrafin 51.*

¹¹⁹ Shtojca 1 e Mocionit, f. 92-94, që u referohen P00010; P00738; P00882; P00959; P00960; P01046; Transkriptit të seancës, 11 dhjetor 2023, f. 10923-10924, 10926-10929, 10947; Transkriptit të seancës, 29 janar 2024, f. 12000-12007, 12019, 12024, 12044; Transkriptit të seancës, 30 janar 2024, f. 12138.

tregues shtesë i burimit dhe prejardhjes së materialit;¹²⁰ dhe (ii) në provat materiale të propozuara 90, 99, 104-106 dhe 110 përmenden emra dhe fakte të referuara edhe në prova materiale të tjera të pranuar dhe/ose të shtjelluara prej dëshmitarëve përkatës gjatë dëshmive të tyre.¹²¹ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se deklaratat kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

52. Në lidhje me procesverbalet dhe analizën e hetimeve, Trupi Gjykses vëren se provat materiale të propozuara 93-96 përbëhen nga dokumente që ofrojnë hollësi për të dyshuarit nën hetim si dhe emrat e individëve të tjerë, vendndodhjet dhe ngjarjet. Gjithashtu, provat materiale të propozuara 93-95 kanë data. Trupi Gjykses mban gjithashtu parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 93 dhe 95 janë versione identike (me përjashtim të një faqeje) të të njëjtit dokument dhe përmbajnë informacion që përkon me atë të përfshirë në provat materiale të propozuara 79, 83, 85 dhe 124;¹²² (ii) provat materiale të propozuara 94 dhe 96 përmbajnë detaje të cilave u referohen edhe provat materiale të propozuara 88-91 dhe 98;¹²³ dhe (iii) prova materiale e propozuar 96 përfshin informacion që përkon me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 88-92, 94, 98, dhe me një pjesë të dëshmisë së W04746-ës.¹²⁴ Kjo është tregues i mëtjeshëm i prejardhjes dhe burimit të këtij materiali. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se procesverbalet dhe analiza kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

¹²⁰ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafët 49-50 dhe më poshtë paragrafin 52.*

¹²¹ Shtojca 1 e Mocionit, *që u referohet*, në pjesët përkatëse, provave P00010; P00738; P00957, P00959; P00960; P01046; 1D00007; Transkriptit të seancës, 12 korrik 2023, f. 5592-5594; Transkriptit të seancës, 11 dhjetor 2023, f. 10923-10924, 10926-10929, 10947; Transkriptit të seancës, 29 janar 2024, f. 11995-11996, 12000-12007, 12017-12019, 12021-12022, 12025, 12044; Transkriptit të seancës, 30 janar 2024, f. 12138.

¹²² Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafët 49, 51.*

¹²³ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafët 49, 51.*

¹²⁴ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu transkriptin e seancës, 12 korrik 2023, f. 5592-5594. Shih gjithashtu më lart paragrafët 49, 51.*

53. Në lidhje me listat, Trupi Gjykses thekson se në to përmenden emrat dhe profesionet e disa anëtarëve të LDK-së dhe policëve serbë.¹²⁵ Gjithashtu, Trupi Gjykses mban parasysh argumentin e ZPS-së se prova materiale e propozuar 131 përmban informacion për bashkëpunëtorët e pretenduar të një lloji të ngjashëm me atë që përmban prova materiale e propozuar 237.¹²⁶ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se listat kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

54. Lidhur me letërnjoftimin, Trupi Gjykses thekson se ai: (i) është një dokument i nënshkruar, me mbishkrimin UÇK në krye të tij, emblemën dhe vulën e saj; (ii) ka një fotografi dhe emrin e mbajtësit të dokumentit; dhe (iii) në të tregohet z. Latif Gashi, shefi i shërbimit ushtarak të zbulimit, si autoritet lëshues i dokumentit.¹²⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se letërnjoftimi ka tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, është *prima facie* autentik.

55. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131 janë *prima facie* autentike.

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

56. Pasi ka konstatuar se provat materiale të propozuara 78-131 janë *prima facie* relevante dhe autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë gjithashtu vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje, siç përshkruhet më lart në paragrafin 47.¹²⁸

¹²⁵ Provat materiale të propozuara 123, 131.

¹²⁶ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu me poshtë* paragrafin 67.

¹²⁷ Prova materiale e propozuar 129.

¹²⁸ *Shih* Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet PV.1. Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet U000-9108-U000-9124 të provës materiale të propozuar 121 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 106, 117. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet 3-39, 52-60 të provës materiale të propozuar 124 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 105, 110.

57. Trupi Gjykses më tej konsideron se Mbrojtja mund të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës si palë jothirrëse si dhe përmes paraqitjes së provave, nëse zgjedh ta bëjë këtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e provave materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

(d) Përfundim

58. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 78-106 dhe 108-131 janë të pranueshme në bazë të rregullës 138(1).¹²⁹

5. Provat materiale të propozuara 132-290: organizimi i UÇK-së dhe qëllimi i kriminal i përbashkët i pretenduar në verën e vitit 1999

59. Fillimisht, Trupi Gjykses autorizon ZPS-në: (i) të zëvendësojë përkthimet e paraqitura në Mocionin për provat materiale të propozuara 176, 235, 246 dhe 262 me përkthimet e rishikuara të vëna në dispozicion në paketën 1212 të materialit të nxjerrë; dhe (ii) të bëjë korrigjime në meta të dhënat e provave materiale të propozuara 272-273.¹³⁰

(a) Relevanca

60. Në lidhje me relevancën e provave materiale të propozuara 132-290, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja parashtro se ato lidhen me organizimin e UÇK-së dhe

¹²⁹ Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar vetëm faqet U000-9108-U000-9124 të provës materiale të propozuar 121 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 106, 117, 128. Trupi Gjykses gjithashtu rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar vetëm faqet 3-39, 52-60 të provës materiale të propozuar 122 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimet 105, 110, 128.

¹³⁰ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 6(c)-(d).

qëllimin kriminal të përbashkët të pretenduar në verën e vitit 1999.¹³¹ Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 132-136 dhe 269 përbëhen nga dokumente që përmbajnë emrat e anëtarëve të asaj kohe dhe të ardhshëm të policisë ushtarake të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit (“listat e personelit”); (ii) provat materiale të propozuara 137-141 janë formularë standardë të paplotësuar të policisë ushtarake të UÇK-së në Zonën Operative të Llapit (“formularët”); (iii) provat materiale të propozuara 142-143, 147-148, 154-155, 189, 196, 216 dhe 279 janë fletore me shënime dhe ditarë të policisë ushtarake të UÇK-së dhe shërbimit të zbulimit, që përmbajnë rrëfime të hollësishme të ngjarjeve dhe personave të përfshirë (“fletoret me shënime”); (iv) provat materiale të propozuara 145-146, 149-150, 192, 199, 209,¹³² 211, 223, 232, 256, 272, 275, 280 dhe 286-290 janë raporte të brendshme, shënime, evidenca shërbimi, dokumente, letra dhe njoftime – të shkruara me dorë dhe të daktilografuara – të policisë ushtarake të UÇK-së dhe shërbimit të zbulimit në lidhje me organizimin dhe operacionet që zhvilloheshin në atë kohë (“raportet”); (v) provat materiale të propozuara 144, 151-153, 157, 161-163, 165, 169, 173, 175-178, 180-183, 185-186, 188, 190, 195, 207, 210, 212-214, 215, 222, 224-225, 228-231, 233-240, 242-254, 257-261, 263-267, 270-271, 273-274, 277-278 dhe 282-283 janë dokumente zyrtare të lëshuara prej policisë ushtarake të UÇK-së dhe shërbimit të zbulimit, ku përfshihen autorizime, fletëthirrje, shënime zyrtare, një konfirmim konfiskimi, deklarime, raporte, direktiva, verifikime, deklarata, dosje hetimore, procesverbale, ankesa dhe një dokument udhëtimi (“dokumentet zyrtare të policisë ushtarake”); (vi) provat materiale të propozuara 156, 158-160, 164, 166-168, 171-172, 174, 184, 191, 194, 197-198, 200, 202-206, 208, 217, 226-227, 255, 262, 281 dhe 285 janë deklarata dëshmitarësh me shkrim dore dhe të daktilografuara, ankesa, kërkesa dhe

¹³¹ *Shih* Shtojcën 1 të Mocionit, f. 100-188, Provat materiale të propozuara 132-290.

¹³² Trupi Gjykses thekson se versionin në anglishte të provës materiale të propozuar 209 (SITF00243877-00243878-ET) të paraqitur prej ZPS-së, nuk përfshin përkthimin e faqeve SITF00243879-00243880. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses ka vlerësuar vetëm faqet SITF00243877-00243878 të provës materiale të propozuar 209 dhe përkthimin përkatës.

shënime informative, të cilat janë mbledhur, marrë ose hartuar nga policia ushtarake e UÇK-së dhe në të cilat evidentohen emra, vendndodhje dhe ngjarje të ndryshme (“deklaratat dhe ankesat”); (vii) provat materiale të propozuara 170, 187, 193, 201 dhe 241 janë dokumente të UÇK-së që përmbajnë vendime zyrtare, kërkesa, deklarata dhe shënime të lëshuara nga dhe brenda Zonës Operative të Llapit, dhe një evidencë të shërbimit operativ të UÇK-së (“dokumentet e tjera të UÇK-së”); (viii) provat materiale të propozuara 179, 268 dhe 276 janë dokumente zyrtare të lëshuara prej Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (“QPK”) dhe drejtuar asaj, dhe përmbajnë, përkatësisht, një urdhër dhe dy kërkesa (“dokumentet zyrtare të QPK-së”); (ix) provat materiale të propozuara 218-221 janë dokumente që përmbajnë lista, përkatësisht, të individëve serbë dhe anëtarëve të pakicës egjiptiane (“listat e tjera”); dhe (x) prova materiale e propozuar 284 është një kërkesë drejtuar shërbimit të zbulimit për të verifikuar punonjësit e aeroportit të Prishtinës (“kërkesa”).

61. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se ZPS-ja mbështetet në provat materiale të propozuara 132-290 në lidhje me organizimin e UÇK-së, në veçanti, policisë dhe shërbimit të zbulimit në Zonën Operative të Llapit si dhe Gardës Kombëtare të themeluar në maj 1999, si dhe kapacitetin e tyre për të kryer hetime, përfshirë: (i) lëshimin, në formularë të standardizuar dhe në përputhje me rregulloret e UÇK-së, të urdhrave dhe fletëthirrjeve; (ii) konfiskimin dhe ndarjen e pronës dhe marrjen e ankesave; (iii) disiplinimin e ushtarëve, përfshirë për “gënjeshtër dhe shkelje të ligjit ushtarak”; (iv) hetimin e krimeve të luftës të kryera prej autoriteteve serbe dhe kontesteve pronësore; (v) kryerjen e inspektimeve, vëzhgimeve dhe kontrollimeve në vendngjarje dhe në vendet e kryerjes së krimeve; dhe; (vi) mbledhjen e informacionit, keqtrajtimin, arrestimin dhe marrjen e deklaratave prej, ndër të tjerë, personave të kombësisë serbe dhe rome, që pretendohet se ishin bashkëpunëtorë, dhe prej kundërshtarëve të tjerë.¹³³

¹³³ Mocioni, para. 15-16.

62. Pasi shqyrtoi me kujdes provat materiale të propozuara 132-290, Trupi Gjykses është bindur se ato lidhen me ngjarjet, faktet dhe rrethanat në Zonën Operative të Llapit në verën e vitit 1999, të cilat janë mjaftueshëm të lidhura me pretendimet dhe akuzat e përfshira në Aktakuzë¹³⁴ si dhe me disa dëshmi të dëshmitarëve.¹³⁵ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se provat materiale të propozuara 132-290 janë *prima facie* relevante.

(b) Autenticiteti

63. Në lidhje me autenticitetin, Trupi Gjykses vëren se listat e personelit janë dokumente ku renditen të dhënat personale të anëtarëve të atëhershëm dhe të ardhshëm të njësitit të policisë ushtarake të UÇK-së. Gjithashtu: (i) prova materiale e propozuar 134 ka nënshkrimin e shtypur të komandantit të policisë ushtarake Muhamet Latifi; (ii) prova materiale e propozuar 136 ka një nënshkrim; dhe (iii) prova materiale e propozuar 269 ka mbishkrimin UÇK në kreun e saj me datën, vendin dhe numrin e referencës dhe në të përmendet policia ushtarake si autoritet lëshues. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentin e ZPS-së se provat materiale të propozuara 132-136 dhe 269 përmbajnë informacion që përkon dhe/ose informacion të një lloji të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 129, 143-145, 173, 178, 188, 206, 250, 258, 264-265, 274, 277 dhe 289.¹³⁶ Ky është një tregues shtesë i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se listat e personelit kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

¹³⁴ Shih p.sh. Aktakuzën, para. 18-55, 71-73, 76, 107-108, 110-111, 157-158. Shih Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet R.1

¹³⁵ Shih p.sh. W04758-ën.

¹³⁶ Shtojca 1 e Mocionit. Shih gjithashtu më lart paragrafin 54, dhe më poshtë paragrafët 65-68.

64. Në lidhje me formularët, Trupi Gjykses vëren se këta janë formularë standardë të daktilografuar dhe të paplotësuar, me mbishkrimin UÇK në kreun e tyre dhe/ose emblemën e saj dhe referenca për policinë ushtarake si autoritet lëshues. Gjithashtu, prova materiale e propozuar 138 ka një referencë për vendin e pritshëm të lëshimit. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentin e ZPS-së se versione (të ngjashme) të nënshkruara të formularit standard në provat materiale të propozuara 139 dhe 141, janë përfshirë, përkatësisht, në provat materiale të propozuara 162, 260 dhe 121.¹³⁷ Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se formularët kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentikë.

65. Në lidhje me fletoret me shënime, Trupi Gjykses thekson se ato përbëhen nga dokumente të shkruara me dorë, ku jepen rrëfime të hollësishme për ngjarjet që kanë ndodhur në Zonën Operative të Llapit dhe personat e përfshirë në to, ku ka dhe lista të individëve serbë dhe shqiptarë dhe informacione për kontaktet e tyre me serbët. Gjithashtu: (i) provat materiale të propozuara 142-143, 147-148, 154-155, 196 dhe 279 përmbajnë referenca për datat relevante në vitin 1999; (ii) provat materiale të propozuara 142-143, 148, 154-155 dhe 196 kanë nënshkrime; dhe (iii) provat materiale të propozuara 143, 147 dhe 154-155 kanë mbishkrimin policia ushtarake në kreun e tyre dhe/ose emblemën, ose në to evidentohet Zona Operative e Llapit si autoritet lëshues. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 154 dhe 189 kanë informacion që përkon me njëri tjetrin;¹³⁸ (ii) në provat materiale të propozuara 142-143, 148, 154, 216 dhe 279 përmenden emra dhe fakte, të cilat përmenden dhe në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 124, 129, 132, 156, 163, 175, 215, 219, 231, 235, 237, 256 dhe 286;¹³⁹ dhe (iii) në provën materiale të propozuar 279 përmenden emra dhe fakte të cilat përmenden edhe në provën

¹³⁷ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 50.*

¹³⁸ Shtojca 1 e Mocionit.

¹³⁹ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih më lart paragrafët 49, 54, 63, dhe më poshtë paragrafët 66-68, 71.*

materiale të pranuar P00902.¹⁴⁰ Ky është tregues i mëtëjshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se prova materiale e propozuar 279 ka një volum prej 112 faqesh dhe, rrjedhimisht, pranimi në tërësi i saj nuk duket i përshtatshëm. Trupi Gjykses është i mendimit se ZPS-ja duhet të përcaktojë fragmentet relevante në të cilat kërkon të mbështetet ose të paraqesë për pranim vetëm faqet relevante përmes dëshmitarëve përkatës. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses refuzon, pa paragjykim, pranimin e provës materiale të propozuar 279. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se, me përjashtim të provës materiale të propozuar 279, fletoret me shënime kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

66. Në lidhje me raportet, Trupi Gjykses thekson se ato janë dokumente të brendshme të policisë ushtarake ku përmenden data, vende, individë dhe/ose ngjarje relevante, dhe në to ka referenca për policinë ushtarake të Zonës Operative të Llapit dhe shërbimin e zbulimit si autoritet lëshues ose marrës i raporteve. Gjithashtu: (i) provat materiale të propozuara 145, 150, 192, 199, 211, 223, 286, 287 dhe 289 kanë nënshkrime të anëtarëve të policisë ushtarake, ndër ta dhe komandanti Muhamet Latifi; (ii) prova materiale e propozuar 209¹⁴¹ ka nënshkrimin e një individi që ankohet në policinë ushtarake; (iii) provat materiale të propozuara 149 dhe 289 kanë mbishkrimin UÇK/Zona Operative e Llapit në kreun e tyre; (iv) prova materiale e propozuar 275 ka datë, emrat e individëve që raportojnë dhe i adresohet Zonës Operative të Llapit; (v) provat materiale të propozuara 287-288 kanë numër reference; dhe (vi) prova materiale e propozuar 289 u sekuestrua në banesën e z. Selimi.¹⁴² Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se në provat materiale të propozuara 145-146, 199, 211, 256, 272, 286 dhe 289-290 përmenden emra dhe fakte, të cilat përmenden dhe në pjesët

¹⁴⁰ Shtojca 1 e Mocionit.

¹⁴¹ Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet SITF00243877-00243878 të provës materiale të propozuar 209 dhe përkthimin përkatës. *Shih më lart* poshtëshënimin 132.

¹⁴² *Shih më lart* poshtëshënimin 99. *Shih gjithashtu më lart* paragrafin 26.

përkatëse të provave materiale të propozuara 124, 127, 129, 134-135, 143, 163, 167, 172-173, 178, 188, 205, 213, 215, 218-219, 237, 250, 258, 264-265, 269, 274, 277 dhe 279,¹⁴³ çka është tregues i mëtejshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se raportet kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

67. Lidhur me dokumentet zyrtare të policisë ushtarake, Trupi Gjykses thekson se ato janë autorizime, fletëthirrje, shënime zyrtare, raporte, direktiva, deklarata dhe dokumente të ngjashme me këto, të lëshuara nga policia ushtarake e Zonës Operative të Llapit ose nga shërbimi i zbulimit dhe ku tregohet data dhe/ose vendi si dhe emrat dhe/ose nënshkrimet e anëtarëve të policisë ushtarake që i kanë hartuar ato. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje se provat materiale të propozuara 152-153, 157, 161-163, 165, 169, 173, 175-178, 180-183, 185-186, 188, 190, 195, 207, 212-215, 224-225, 229-231, 233-240, 242, 245-247, 249-254, 257-261, 263-267, 270-271, 274, 277 dhe 282-283 kanë mbishkrimin UÇK ose vulën e saj në kreun e tyre dhe/ose numër reference, dhe në to përmendet policia ushtarake e Zonës Operative të Llapit ose shërbimi i zbulimit si autoritet lëshues. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) provat materiale të propozuara 151, 163, 173, 250, 185, 188, 173, 178, 212-214, 224-225, 240, 243-244, 258, 264-265, 274 dhe 277-278 kanë informacion përkues;¹⁴⁴ (ii) provat materiale të propozuara 144, 157, 173, 175, 178, 180, 183, 188, 213-215, 224-225, 229-231, 233, 235-236, 239, 243, 245-247, 249, 252, 254, 258-259, 263-264, 266-267, 273-274 dhe 277 kanë informacion të një lloji ose formati të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 127, 129, 134-135, 142-143, 167, 200, 204, 226-227, 269, 276, 279 dhe 289;¹⁴⁵ dhe (iii) në provat materiale të propozuara 260 dhe 273 përmenden rregullore, emra ose ngjarje të cilat përmenden dhe në

¹⁴³ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart* paragrafët 49, 54, 63, 65, dhe *më poshtë* paragrafët 67-68, 71.

¹⁴⁴ Shtojca 1 e Mocionit.

¹⁴⁵ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart* paragrafët 49, 54, 63, 65-66 dhe *më poshtë* paragrafët 68, 70.

provat materiale të pranuara, përkatësisht, P00008 dhe P00269.¹⁴⁶ Ky është tregues i mëtejshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet zyrtare të policisë ushtarake kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

68. Në lidhje me deklaratat dhe ankesat, Trupi Gjykses thekson se ato janë dokumente që përmbajnë rrëfime të hollësishme të ngjarjeve të ndodhura në Zonën Operative të Llapit në verën e vitit 1999. Gjithashtu: (i) provat materiale të propozuara 156, 158, 166-167, 171-172, 174, 184, 191, 194, 197-198, 202, 204-206, 208, 262, 281 dhe 285 kanë datat përkatëse; (ii) provat materiale të propozuara 164-165, 167-168, 171-172, 184, 191, 194, 197-198, 200, 202-206, 208, 226-227, 255 dhe 262 kanë nënshkrime; (iii) provat materiale të propozuara 167-168, 198, 200, 202-206, 208, 255 dhe 285 kanë mbishkrimin UÇK në kreun e tyre dhe/ose numra reference; dhe (iv) në provat materiale të propozuara 156, 159-160, 164, 167-168, 171, 184, 194, 198, 200, 202-205, 208, 217, 255 dhe 281 evidentohet policia ushtarake e Zonës Operative të Llapit si autoritet lëshues ose marrës i tyre. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) koha të cilës i përkasin provat materiale të propozuara 168, 200 dhe 203, nga njëra anë, dhe prova materiale e propozuar 226, nga ana tjetër, mund të deduktohet nga konteksti dhe të dhënat përkatëse të përfshira, përkatësisht, në provat materiale të propozuara 167 dhe 227;¹⁴⁷ (ii) provat materiale të propozuara 158-160, 166-168 dhe 226-227 kanë informacion përkues;¹⁴⁸ dhe (iii) në provat materiale të propozuara 158-160, 166-167, 172, 191, 217 dhe 227 përmenden emra dhe fakte, të cilat përmenden dhe në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 129, 142-143, 155, 163, 183, 214-215, 225, 233, 236, 264, 269, 277, 279, dhe 289.¹⁴⁹ Ky është tregues i mëtejshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se

¹⁴⁶ Shtojca 1 e Mocionit, f. 164, 173. *Shih në veçanti* P00008, f. 14; P00269, f. 17.

¹⁴⁷ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih në veçanti* provën materiale të propozuar 167, f. 5-8, 10-13; provën materiale të propozuar 227, f. 1-2.

¹⁴⁸ Shtojca 1 e Mocionit.

¹⁴⁹ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart* paragrafët 54, 63, 65-67.

deklaratat dhe ankesat kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

69. Në lidhje me dokumentet e tjera të UÇK-së, Trupi Gjykses thekson se: (i) provat materiale të propozuara 170, 201 dhe 241 kanë mbishkrimin UÇK në kreun e tyre dhe/ose emblemën e saj; (ii) provat materiale të propozuara 170 dhe 201 janë të nënshkruara, përkatësisht nga komandanti dhe zëvendëskomandanti i Zonës Operative të Llapit; (iii) provat materiale të propozuara 187, 241 dhe 193 kanë nënshkrime të komandanteve dhe anëtarëve të UÇK-së; dhe (iv) provat materiale të propozuara 170, 187 dhe 241 kanë data. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentin e ZPS-së se në provat materiale të propozuara 187 dhe 201, nga njëra anë, dhe provën materiale të propozuar 193, nga ana tjetër, përmenden individë dhe ngjarje të cilave u referohen, përkatësisht, edhe provat materiale të propozuara 129 dhe 143.¹⁵⁰ Ky është tregues i mëtëjshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet e tjera të UÇK-së kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

70. Në lidhje me dokumentet zyrtare të QPK-së, Trupi Gjykses thekson se: (i) prova materiale e propozuar 179 ka datë, është e nënshkruar, ka numër reference dhe në të evidentohet autoriteti komunal i Podujevës si autoritet lëshues; (ii) prova materiale e propozuar 268 është e nënshkruar, ka datë, është e vulosur dhe në të tregohet vendi, numri i referencës dhe Ministria e Rendit Publik e QPK-së si marrës i saj; dhe (iii) prova materiale e propozuar 276 është e nënshkruar dhe ka datë, në të tregohet data, vendi dhe numri i referencës, ajo ka mbishkrimin QPK në kreun e saj dhe vulën dhe në të evidentohet një drejtor i QPK-së si autoritet lëshues. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentet e ZPS-së se: (i) në provën materiale të propozuar 179 përmendet një individ, emërimi i të cilit

¹⁵⁰ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafët 54, 65.*

përmendet në provën materiale të propozuar 279;¹⁵¹ (ii) provat materiale të propozuara 267-268 kanë informacion përkues;¹⁵² dhe (iii) prova materiale e propozuar 276 është e ndërlidhur me provën materiale të propozuar 277.¹⁵³ Ky është tregues i mëtëjshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se dokumentet zyrtare të QPK-së kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

71. Lidhur me listat e tjera, Trupi Gjykses thekson se ato përbëhen nga dokumente të daktilografuara dhe të shkruara me dorë, ku tregohen emrat dhe mbiemrat e disa individëve si dhe pretendimet për krimet që supozohet se kanë kryer disa prej tyre. Veç kësaj, prova materiale e propozuar 221 është e vulosur. Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh argumentin e ZPS-së se listat e tjera përmbajnë informacion të një lloji të ngjashëm me atë të përfshirë në pjesët përkatëse të provave materiale të propozuara 124, 215 dhe 237,¹⁵⁴ çka është tregues i mëtëjshëm i burimit dhe prejardhjes së materialit në fjalë. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se listat e tjera kanë tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, janë *prima facie* autentike.

72. Në lidhje me Kërkesën, Trupi Gjykses thekson se ajo ka datë dhe logon e aeroportit të Prishtinës, është e nënshkruar prej drejtorit të aeroportit dhe ka vulën zyrtare të aeroportit. Gjithashtu, në kërkesë ka të dhëna personale të punonjësve të aeroportit. Për këto arsye, trupi Gjykses është bindur se kërkesa ka tregues të mjaftueshëm të autenticitetit dhe, rrjedhimisht, është *prima facie* autentike.

73. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 132-278 dhe 280-290 janë *prima facie* autentike.

¹⁵¹ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 65. Shih në veçanti* provën materiale të propozuar 279, f. 5.

¹⁵² Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 67.*

¹⁵³ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafin 67.*

¹⁵⁴ Shtojca 1 e Mocionit. *Shih gjithashtu më lart paragrafët 49, 67.*

(c) Vlera provuese nuk zhbëhet prej efektit dëmtues

74. Pasi konstatoi se provat materiale të propozuara 132-278 dhe 280-290 janë *prima facie* relevante dhe autentike, Trupi Gjykses është bindur se këto materiale kanë edhe vlerë provuese *prima facie* në lidhje me faktet dhe rrethanat relevante për këtë çështje, siç përshkruhet më lart në paragrafin 61.¹⁵⁵

75. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se Mbrojtja do të ketë mundësi të kundërshtojë përmbajtjen e këtyre materialeve përmes marrjes në pyetje të dëshmitarëve përkatës si palë jothirrëse, si dhe përmes paraqitjes së provave, nëse zgjedh ta bëjë këtë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se vlera provuese e provave materiale të propozuara 132-278 dhe 280-290 nuk zhbëhet prej efektit dëmtues të tyre.

(d) Përfundim

76. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses është bindur se provat materiale të propozuara 132-278 dhe 280-290 janë të pranueshme sipas rregullës 138(1).¹⁵⁶ Trupi Gjykses refuzon, pa paragjykim, pranimin e provës materiale të propozuar 279.

V. KLASIFIKIMI

77. Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative që t'u caktojë materialeve të pranuar klasifikimin e treguar në Shtojcën 1 të Mocionit.

¹⁵⁵ Shih Shtojcën 1 të Përgjigjes, kundërshtimet PV.1. Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet SITF00243877-00243878 të provës materiale të propozuar 209 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 132, 141.

¹⁵⁶ Trupi Gjykses rikujton se ka vlerësuar vetëm faqet SITF00243877-00243878 të provës materiale të propozuar 209 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 132, 141, 155.

VI. VENDIM

78. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- (a) **MIRATON** pjesërisht Mocionin;
- (b) **AUTORIZON** ZPS-në që të përfshijë Dokumentin Shtesë në listën e provave materiale;
- (c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë listën e ndryshuar të provave materiale deri të premten, 28 shkurt 2025;
- (d) **RRËZON** kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e shqyrtimit të Mocionit deri pasi të kenë dhënë dëshmitë e tyre dëshmitarët e ZPS-së për Zonën Operative të Llapit;
- (e) **PRANON** si prova këto prova materiale të propozuara : 1-16, 18-27, 29-48, 50-106,¹⁵⁷ 108-278,¹⁵⁸ dhe 280-290, dhe, varësisht prej nënparagrafit (h) më poshtë, çdo përkthim të tyre;
- (f) **REFUZON**, pa paragjykim, pranimin e provës materiale të propozuar 279;
- (g) **E DEKLARON** të tejkualuar kërkesën për pranimin e provave materiale të propozuara 17, 28, 49, 107 dhe faqeve 1-2, 40-51 të provës materiale të propozuar 124;
- (h) **AUTORIZON** ZPS-në që: (i) të zëvendësojë përkthimet e paraqitura në Mocion të provave materiale të propozuara 176, 235, 246 dhe 262 me

¹⁵⁷ Shih Shtojcën 1 të Mocionit. Trupi Gjykues rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar si prova vetëm faqet U001-0243-U001-0244 të provës materiale të propozuar 59 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 63, 95, 101, 102.

¹⁵⁸ Shih Shtojcën 1 të Mocionit. Trupi Gjykues rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar si prova vetëm faqet U000-9108-U000-9124 të provës materiale të propozuar 121 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 106, 117, 128, 129. Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar si prova vetëm faqet 3-39, 52-60 të provës materiale të propozuar 124 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 105, 110, 128, 129. Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se ka vlerësuar dhe pranuar si prova vetëm faqet SITF00243877-00243878 të provës materiale të propozuar 209 dhe përkthimin përkatës. Shih më lart poshtëshënimet 132, 141, 155, 156.

përkthimet e rishikuara të vëna në dispozicion në paketën 1212 të materialeve të nxjerra; dhe (ii) të bëjë korrigjime në meta të dhënat e provave materiale të propozuara 9 dhe 272-273; dhe

- (i) **UDHËZON** Zyrën Administrative t'u caktojë materialeve të pranuar:
- (i) numra prove;¹⁵⁹ dhe (ii) klasifikimin e përmendur në Shtojcën 1 të Mocionit.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E premte, 21 shkurt 2025

Në Hagë, Holandë.

¹⁵⁹ Trupi Gjykues udhëzon Zyrën Administrative t'i përfshijë në provën materiale P00738 faqet e pranuar të provës materiale të propozuar 124 dhe përkthimin përkatës të tyre. *Shih më lart* poshtëshënimet 105, 158.